



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)** - Rahovec, e mbajtur më **24.01.2025**, me fillim në orën **15:00**. Mbledhjen e kryesoi Nënkyetari Komunës z. **Fatmir Iska**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston. Në fillim të mbledhjes, të pranishëm ishin 22 anëtarë.

Nënkyetari: Më lejoni t'i përvendos anëtarët e KKSBB-së, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, OSBE-së, LMT-së, UN-it, KLSP-së, zyrtarët komunalë dhe mediat. Sot janë edhe disa kryetarë të këshillave të lagjeve urbane dhe disa kryetarë të këshillave të fshatrave. Është mbledhja e **parë** e rregullt për vitin 2025 me plan të ri. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë rreth aktiviteteve të KKSBB-së, gjatë vitit 2024;**
- 3. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2024;**
- 4. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
 - Siguria në trafik,
 - Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit.
- 5. Trajtimi i qenve endacakë;**
- 6. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;**
- 7. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;**
- 8. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;**
- 9. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit;**
- 10. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;**
- 11. Të ndryshme.**

Nënkyetari: A ka dikush ndonjë koment për këtë rend dite? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”... Kundër... Konstatoj që ne mund të vazhdojmë me këtë rend dite.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Nënkyetari: Para se të kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, në emrin tim dhe besoj edhe në emrin e të gjithë anëtarëve të KKSBB-së, ia uroj ditëlindjen komandantit Fazli Morina, shëndet dhe suksese!

Vazhdojmë me pikën e parë. A ka dikush ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është “për”... Kundër... Aprovohet procesverbalii nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë rrreth aktiviteteve të KKSBB-së, gjatë vitit 2024:

Nënkyetari: Besoj që secili anëtar i KKSBB-së e ka një informatë rrreth aktiviteteve të KKSBB-së për vitin 2024. Janë mbajtur 8 takime, 7 kanë qenë sipas planit dhe një tjetër urgjente. Janë trajtuar tema të ndryshme, kryesisht të sigurisë në komunën tonë.

3. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2024:

Nënkyetari: Unë shpresoj që ne jemi dakord që gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit është e qetë, stabile dhe pa ndonjë ndryshim thelbësor nga mbledhja e kaluar. Vazhdojmë të kontribuojmë bashkërisht në sigurinë e përgjithshme në komunën e Rahovecit. Kjo pikë lidhet edhe me pikën e katërt dhe për më tepër fjalën ia kalojmë kapitenit, z. Fazli Morina.

4. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:

Fazli Morina: Faleminderit nënkyetar! Të nderuar pjesëmarrës, drejtore të drejtorive, përshëndetje për anëtarët e KKSBB-së. Si zakonisht do të raportoj në pikë të shkurta rrreth situatës së sigurisë në territorin e komunës së Rahoveci me statistika si në vijim: Ndoshta së fundmi po shihni më pak policë prezantë në rrugë, sepse për momentin është aktive akoma asistimi me zyrtarë policorë në veri. Gjatë kësaj kohe janë iniciuar disa vepra penale pranë stacionit, 55 raste vepra penale, 4 incidente, një rast me narkotikë, 4 raste me para falco, 7 raste të asgjësimit të pasurisë, 1 rast armëmbajtje pa leje, 7 raste të dhunës në familje dhe 28 urdhëresa të gjykatës. Gjatë kësaj periudhe janë arrestuar 14 persona. Sa i përket sigurisë në komunikacion: Janë dhënë 922 gjoba në komunikacion rrugor. Prej tyre, 694 për kundërvajtje, 20 gjoba janë shqiptuar për drejtimin e automjetit pa patent shofer, 190 gjoba për parkingje joadekuate, 9 gjoba për përdorim të telefonit gjatë drejtimit të automjetit, 3 gjoba për prishjes të rendit dhe qetësisë publike dhe kanë ndodhur 23 aksidente me dëme materiale dhe 18 me lëndime dhe përfat të mirë aksidente me fatalitet nuk kemi pasur. Nga shkollat e komunës së Rahovecit janë realizuar 2 raste: Vjedhje e rëndë dhe posedim i substancave narkotike. Afër shkollave janë bërë 234 patrullime dhe 17 pikë kontrolli. Një aksion tjetër ka qenë ku zyrtarisht është bërë mbyllja e dy objekteve të strukturave paralele.

Shaip Shala: Faleminderit! Komandant, urime ditëlindja! T'ju tregoj të vërtetën e kam pritur procesverbalin e mbledhjes së kaluar, përfat që lexuar Bujarin, sepse atë ditë nuk e kam kuptuar kur i ka përmendur disa përqindje. Ka qenë fjala për lëmoshëkërkuesit. Bujar, lëmoshëkërkuesit janë kontrabanda e njerëzve, janë vepër penale dhe janë zingjir kryesisht nga Shqipëria. Nuk je kompetent, as ti e as unë që kinse 70% janë nga Shqipëria, pjesa tjetër nga Kosova. Nga komuna e Rahovecit nuk janë as 7, sepse të gjithë i njoh. Kur thua që nuk ka rrezik, unë them që rrezik janë edhe përfat shtetin dhe jo vetëm përfat komunën tonë. Keni thënë që nuk janë agresivë. Përveç që kam qenë objekt i agresivitetit të një lëmoshëkërkuese, duke më thënë që "Ani mos më jep para, por mbylle gojën", ndërsa unë edhe e mbylla gojën, edhe "bishtin" e ula poshtë. Është temë përfat t'u diskutuar. Gjithashtu është tmerr kur e sheh në kafiteri duke ardhur një grua me dy foshnje në duar. E kam përmendur që një kombibush i ka zbritur te Bodrumi i Vjetër, por tanë këta zbresin te Viva-Fresh. Besoj që 99% janë nga Shqipëria.

Bujar Morina: Përshëndetje nënkyetar, përshëndetje përfat t'ë gjithë! Së pari, dëshiroj t'i drejtohem drejtorisë së Arsimit me një lutje që, nëse është e mundur që në shkollat e komunës së Rahovecit t'i largojnë telefonat mobilë nga nxënësit, pse jo edhe nga arsimtarët. E shoh si dukuri negative, sepse nëse nxënësi është në klasë me telefon në dorë, përfat që arsimtarja ligjëron, unë nuk e di se si ai nxënës merr dije. Sa i përket replikës përfat bacën Shaip, nuk besoj që keni qenë viktima e lëmoshëkërkuesve, por në qoftëse e keni ngaemuar apo ofenduar me ndonjë fjalë të rëndë, atëherë duhet ta mbash edhe dënimin. E di mirë që shumica janë nga Shqipëria, por nëse nuk e ngacmon atë, ata nuk t'ë ngacmon as me çantë e as me "papuçë".

Shaip Shala: Bujar, pak të bësh kujdes kur diskuton, unë me 75 vjet ta ngacmoj dikë a? Të lutem, turpërohu pak!

Nënkyetari: Ju lus që mos ta degradoni gjuhën, sepse këtu jemi për të diskutuar rrëth temave, që për çka edhe jemi anëtarë të KKSB-së. Temat e tilla mund t'i trajtoni edhe në ndonjë kafe. Shaip, në pikën e parë ju pyeta nëse jemi në rregull me procesverbal, ju thatë po, tani në pikën e katërt po diskuton rrëth procesverbalit.

Fazli Morina: Lëmoshëkërkuesit janë kategori e rëndë dhe shkurt do të tha që mirë e ka Shaipi, por gjithashtu edhe Bujari, si dhe besoj që e kam mirë edhe unë në atë që do t'ju them. Rahoveci është një ndër qytetet që ka më së paku lëmoshëkërkues dhe besojmë që nga varfëria e skajshme janë të detyruar ta bëjnë atë veprim. Sa i përket rrezikut prej tyre, nuk përjashtohet kjo mundësi, mirëpo rrezikshmëria numër një është për vetë trupin dhe jetën e tyre. Mundësia e vetme me vendim të gjykatës është vetëm deportimi i tyre në Shqipëri, nëse janë nga Shqipëria.

Nënkyetari: A ka dikush ndonjë gjë tjetër rrëth kësaj teme? Nëse jo, po i përgjigjem Bujarit në lidhje me temën e telefonave në shkolla. Besoj që janë rregulloret dhe udhëzimet administrative si akte nënligjore që e rregullojnë këtë dukuri dhe shkollat e kanë hierarkinë e tyre që duhet ta trajtojnë këtë problem.

5. Trajtimi i qenve endacakë:

Nënkyetari: Në mungesë të drejtorit të bujqësisë, po ju jap një informatë që, Komuna e Rahovecit ka një kontratë për trajtimin e qenve endacakë dhe komuna në bazë të kësaj kontrate i trajton qentë endacakë në territorin administrativ të komunës. Mbi bazën e kësaj kontrate trajtohen rrëth 1000 qen.

6. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje:

Nënkyetari: Komandanti veçse i dha disa informata. Në stacionin policor janë lajmëruar 7 raste të dhunës në familje dhe sa i përket uljes së këtij numri, besoj që duhet të zhvillohen disa fushata vetëdijësuese, sa i përket parandalimit të kësaj dukurie. Qendra për Punë Sociale gjithashtu i trajton këto problematika.

7. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancës narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme:

Avni Morina: Faleminderit nënkyetar! Të nderuar anëtarë të KKSB-së. Gjatë kësaj periudhe, sigurinë në shkolla e kemi trajtuar si çështje të përditshme. Në bashkëpunim me drejtorët, me policinë dhe me kryetarët e këshillave të shkollave e kemi përcjellë gjendjen e sigurisë, e cila është stabile. Kanë ndodhur dy raste: Një njëren prej kthinateve të objektit të shkollës është gjetur një sasi e vogël, që pas ekzaminimit doli të jetë lënde narkotike. Rasti tjetër ka të bëjë me vjedhjen e disa topave në shkollën "Xhelal Hajda – Toni". Ky rast ka ndodhur gjatë kohës së pushimit dimëror. Përkundër rastit të parë, në këtë rast së pari ka marrë vesh policia e më pas DKA-ja dhe kjo lidhet direkt me papërgjegjësinë e drejtoreshës së shkollës, të cilën më pas e kam kritikuar. Sa i përket përdorimit të telefonave mobilë, ne e kemi një vendim që nga 2018-ta, të cilin e ka nxjerrë Ministria e Arsimit, në atë kohë ministër ka qenë Ramë Likaj. Nëse ministria ka marrë vendim, atëherë vendimi është për të gjitha komunat dhe nuk e di nëse dikush del e thotë kemi marrë vendim e në anën tjetër vendimin veçse është. Vendimin në fuqi po e zbatojmë në shkollat tona, por kjo varet edhe prej angazhimit të mësimdhënësve dhe të prindërve. Ne jemi dëshmitarë të faktit që edhe nëpër familjet tona nuk e kemi lehtë t'ju heqim fëmijëve telefonin nga duart. Mendoj që, në shkollë përdorimi i telefonit nuk është ekstremisht i ndaluar, mund të përdoret nga nxënësi apo nga arsimtari, nëse përdoret për qëllime edukative. Për t'i parandaluar të gjitha dukuritë negative që ndodhin nëpër shkolla, ne si DKA kërkojmë bashkëpunimin e prindërve.

8. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave:

Besmirë Bytyqi: Faleminderit nënkyetar! Të nderuar të pranishëm! Është bërë zakon që njësia e zjarrfikësve, bashkë me stafin e Drejtorisë për Shpëtim, në bashkëpunim me DKA-në të mbajmë trajnime-ligjérata, kryesisht me nxënësit e shkollës së mesme. Këto trajnime mbahen për t'u mësuar se si të reagojmë në raste emergjente, jo vetëm të zjarrit, por në të gjitha rastet emergjente që mund të kanosen. Këtë vit do të mundohemi të trajnojmë edhe personelin që punon nëpër shkolla dhe nëpër institucionet tona publike. Në shumicën e vendeve të punës, punëtorët që punojnë aty nuk dinë si ta përdorin edhe aparatin përfikjen e zjarrit. Së fundmi e kemi një rast

konkret, te fabrika që mori flakë në Sopniq dhe që u bë lajm shumë i keq për komunën tonë. Si KKSBB presim bashkëpunimin tuaj, për ndonjë sugjerim apo këshillë se si mund ta përmirësojmë sigurinë në raste emergjente.

9. Mbrojtja e ambientit në komunën e Rahovecit:

Besmirë Bytyqi: Këtë pikë po e prezentoj meqenëse drejtoresha Norë, për shkak të gjendjes shëndetësore nuk mundi të qëndrojë në këtë mbledhje. Gjatë kësaj periudhe, sektori i mjedisit në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese ka kryer gjithsej 93 inspektime. Nga këto inspektime janë shqiptuar 52 gjoba mandatore, 30 leje të reja biznesore nga bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, 6 gjoba për mungesë të lejes mjedisore dhe 8 fletëparaqitje. Drejtoria e Inspektoratit është e përkushtuar të mbrojë mjedisin dhe të gjitha hapësirat publike.

10. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:

Besmirë Bytyqi: Te sektori i tregut, gjatë vitit 2024 kemi mbikëqyrë të gjitha bizneset dhe tregtarët për të siguruar që ata të ofrojnë produkte të sigurta, të respektojnë normat dhe çmimet e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar 8 gjoba mandatore për mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje çmimesh.

11. Të ndryshme:

Shani Hoti: Përshëndetje për të gjithë! Dëshiroj ta shtroj si çështje mungesën e sinjalistikës në rrugën, Gradish – Kramovik. Kjo është kërkesë edhe e anëtarëve të KLSP-së.

Nënkryetari: Prof, ajo është rrugë regionale dhe trajtohet në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës. Ne si komunë mund t'i drejtohem me një kërkesë ministrisë. E ftoj drejtorin e Shërbimeve Publike apo edhe drejtorin e Financave. Deri më tanë, përgjigjet e tyre në shumicën e rasteve kanë qenë negative.

Avni Morina: Meqenëse jemi në prag të zgjedhjeve nacionale, pas orës 18:00 në koordinim të plotë me KQZ-në dhe policinë e kosovës, iu kemi dhënë leje të gjitha subjekteve politike që të bëjnë fushatë zgjedhore në çdo objekt arsimor të komunës sonë.

Nënkryetari: Faleminderit! Nëse eventualisht dikush nuk ka diçka tjetër, unë po e përfundoj këtë takim. Me shpresë që do të takohemi përsëri sipas kalendarit të KKSBB-së, ju falënderoj për kontributin tuaj.

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi

